

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Nuk do të shembemi nga asnjë sulm'/ Kalaja: Fitorja bashkë do të jetë e padiskutueshme!
ADRESA	https://piranjat.al/politike/nuk-do-te-shembemi-nga-asnje--kalaja-fitorja-bashke-do-te-jete-e-pa-i104535
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:52:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:42:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f953c3dfb57fb85997ac195164e9e63fc2e7392c0c5ac1770bde24596325c4a3
TEKSTI	5e628dfd35ac66d6c6516c79041fc2a2c1bbf0cf4f1c384b5566ac40c51cad8e
PAMJA	129e621cefe25aa69b8a650d21f6cca81dc80b13957e5f5db4055591ffffa8b9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5ee48de9fcc69fa577e1b588c0f2ac92695731fbb06874046c57cc2f912f82e2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a2ff65fb1ec0abbd824a4690f8572392275823afe6c37713ebc7a42874eb87f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5ee48de9fcc69fa577e1b588c0f2ac92695731fbb06874046c57cc2f912f82e2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

bulevardi Ne
do e mbajtur në
takimin e
zhvilluar nga

thërret t'i
japim

pjesë në
Kuvendin e
degës së
Krujës, Gjiro

mln euro,
arrestohet
Eno Agasi
është

pas
dënimit të

për misionet
posaçme, Richard
Grenell, reagoi

norvegjezit

vazhdojnë
qarkullojnë
ndërsa
gazetarët

POLITIKE

‘Nuk do të shembemi nga asnjë sulm’/ Kalaja: Fitorja bashkë do të jetë e padiskutueshme!

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 20:42



Kryetari i Partisë Demokratike në Krujë, Aulon Kalaja, ka mbajtur fjalën e tij në Kuvendin e Partisë Demokratike, dega Krujë, ku ka folur për situatën në zonë, duke akuzuar qeverinë për neglizhencë dhe për atë që ai e cilësoi si cenim të interesave të qytetarëve.

Në fjalën e tij, Kalaja e krahasoi degën e PD-së në Krujë me kalanë e qytetit, duke vlerësuar qëndrueshmërinë e demokratëve dhe duke deklaruar se synimi i tyre është fitorja në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe politike.

Kryetari i PD-së Krujë bëri thirrje për bashkim të demokratëve, duke theksuar nevojën për përfshirjen e figurave me eksperiencë, por edhe afrimin e të rinjve.

Fjala e kryetarit të PD Krujë, Aulon Kalaja:

Përsëendetje Kruja, Fushë-Kruja, Nikla, Bubqi, Malësia e Krujës dhe në fund qyteti i zemrës sime, Kruja. Një duartrokitje!

Ne pra jemi Kruja dhe sot do të tregojmë se ne dimë të kuvendojmë. Dega jonë është një familje e madhe sepse zemra juaj është sa mali i Krujës.

Dega jonë është si kalaja aty; ka qëndresë, ka betejë. Demokratët e degës tonë janë heronjtë e vërtetë, qëndrestarë të pamposhtur ashtu siç qëndronte kohorta pretoriane në krah të Skënderbeut.

Sot jemi mbledhur për të ndërtuar një kala të re që do të fitojë zgjedhjet lokale dhe politike. Kala e re, por që do ta ndërtojmë të fortë.

Nuk do të shembemi nga asnjë sulm. Nuk do të rrëzohemi nga asnjë gjëimim, nuk do të lëkundemi sepse nuk e kemi zakon.

Armikut që na e ktheu tokën e djegur dhe na plaçkiti, sot do t'i japim datën.

Pra, lavdia, motra dhe vëllezër u përket vetëm durimtarëve sepse gjërat gjithmonë vështirësohen përpara se të hapet rruga.

Ndaj sot, i pajisur dhe unë me një durim të madh, dua t'ju them se ora jonë po bie.

Do ta çlirojmë tokën tonë nga kusaria dhe atdheun tonë nga maskarenjtë.

Po, ne na duhet të mbajmë të vjetrit brenda kalasë sonë politike sepse ata i njohin shtigjet dhe të afrojmë gjakun e ri sepse ata janë luftëtarë të vërtetë.

Por kalaja e mirë gjendet në zemrën e qytetarëve, sepse edhe nëse ata kanë kështjella korrupsioni, kundërshtarët tanë nuk do t'i shpëtojnë dot zemëratisë së popullit.

Por pyetja që çdo shqiptar i ndershëm sot bën për Krujën është: Kush e dogji Krujën?

Në mënyrë sistematike Kruja ka 40 ditë që po digjet. Koincidence? Por koincidencecat e përsëritura nuk janë më rastësi.

Çdo ditë sakatohen ullinjtë 500-vjeçarë që çiftet e reja i lulëzonin ikonës së Skënderbeut, kur heroi ynë kombëtar, para se ata të martoreshin dhe të vendosnin kurorë, i detyronte që të mbillnin pemët e zotave në tokën e Krujës.

Jo vetëm Kruja; Krasta, Zidolli, Albanopolisi, Grepça, Mukja dhe Bilaj u përçudnuan me tym e flakë për t'ju grabitur tokat, me të ashtuqajturën, më falni të gjithë, paketa e halleve.

Na grabitën Rinasin sepse ne qen kemi qytetarë të dorës së dytë, se vetëm Tirana është e denjë që ta menaxhojë aeroportin, bizneset dhe tokat e atij fshati, me të cilin ne krutanët kemi lidhje shumë të forta fisnore dhe krushqie.

Motra dhe vëllezër dua t'ju them se deri para pak kohësh unë kam besuar tek një shprehje e Faik Bej Konicës i cili thonte se e vetmja herë kur shqiptarët bashkëpunojnë dhe koordinohen është kur hedhin vallen.

Por sot unë kam një mendim tjetër. Kruja më mësoi se po, ne mund të bëhemi bashkë dhe kur ne vendosim për fitore, ajo është e padiskutueshme.

A nuk hëmë të njëjtën në 11 maj të vitit 2025?

Gjergj Kastrioti na ka mësuar se dhe me 300 shqiptarë, por patriotë, mund të mundësh perandorinë më të madhe.

Imagjinoni se çfarë mund të bëjmë ne sot me këtë sallë, me këta njerëz që janë ulur dhe ka plot në këmbë, kështu që fitorja do të jetë e padiskutueshme.

Për ata që kanë harruar, Kruja është kalaja e pamposhtur e demokratëve, ashtu ka qenë dhe kështu do të jetë.

Prandaj optimist, motra dhe vëllezër, optimist sepse pesimizmi nuk ka fituar asnjë betejë.

Për ziliqarët dhe të tjerë dua t'ju deklaroj se unë e dua Krujën sepse këtu lindi Shqipëria.

Prandaj më lejoni ta mbyll këtë fjalë me një betim latin që bëhet para martesës: Ubi tu, ibi ego (Kudo që të jeni ju, do të jem dhe unë gjithmonë).

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 16 Shtator20:35

[Flamuri i UÇK-së ngrihet para Kryeministritë, protestuesi: Historia e Kosovës u shkrua me gjak!](#)

Vendimi i Dhomave të Specializuara në Hagë për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një nga tem...

POLITIKE 16 Shtator20:28

[“36 vite vjedhje e tradhti kombëtare!”/ Aktivistja: Nesër në dyert e Kuvendit!](#)

Përballë godinës së Kryeministritë, aktivistja Sidorela Vatnikaj ka lëshuar akuza të ashpra ndaj elitës politike në...

POLITIKE 16 Shtator20:21

[“Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur të historisë”, Meidani: Në ç'emër flet kjo gjykatë kur populli i Kosovës proteston?](#)

Ish-Presidenti i kohës së luftës së Kosovës, Rexhep Meidani, ka reaguar pas vendimit të Hagës, e cila dënoi me 81 vite b...

POLITIKE 16 Shtator20:07

[Protestuesi: Ramës s'i mjaftoi shkatërrimi dhe shitja e Shqipërisë, por donte të shkatërronte edhe Dardaninë](#)

Aktivisti Arben Kola ka mbajtur fjalën e tij në protestën e 109-të kundër kryeministrit Edi Rama, duke kritikuar qëndrimet e qever...

POLITIKE 16 Shtator19:58

[Protesta e 109-të kundër qeverisë, aktivisti: Rama është Esat Pasha i ditëve të sotme](#)

Aktivisti Mirjan Aliaj ka marrë fjalën në protestën e 109-të kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama, duke bërë ...

POLITIKE 16 Shtator19:49

[“Në Hagë u luajt teatër, kjo është padrejtësi”, Dritan Goxhaj në protestë: Rama e tradhtoi Kosovën në vitin 2015! “Marre” për atë që ka bërë](#)

Në ditën e 109-të të protestës, ish-luftëtari i UÇK, Dritan Goxhaj mbajti një fjalim shumë të fortë, pi...

POLITIKE 16 Shtator19:44

[Berisha: Protesta e ka zvarritur Ramën për së gjalli çdo natë në bulevard! Ne do e mbështesim atë me të gjithë potencialin tonë](#)

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha gjatë fjalës së mbajtur në takimin e zhvilluar nga dega lokale në Krujë, ka folu...

POLITIKE 16 Shtator19:28

[Berisha: Ripërtëritja e PD-së është jetike. Ajo nuk vjen në pushtet për lavdinë e shkuar, por për vizionin për të ardhmen](#)

Lideri i demokratëve Sali Berisha i pranishëm në Kuvendin zgjedhor të degës së PD-së në Krujë, është shpr...

POLITIKE 16 Shtator19:20

[“Nesër mosbindje civile te Parlamenti” – Arben Kola: Momenti i përplasjes me qeverinë dhe deputetët e korruptuar! Vezët janë mjet demokratik](#)

Protestat popullore kundër qeverisë së Edi Ramës kanë hyrë në ditën e tyre të 109-të, teksa revolta ndaj afëra...

POLITIKE 16 Shtator19:18

[Dita e 109-të e protestës, qytetarët marshojnë nga sheshi “Skënderbej” drejt Kryeministritë, kërkojnë largimin e Edi Ramës](#)

Ka nisur marshimi nga sheshi Skënderbej drejt Kryeministritë. Sot bëhen 109 që qytetarët protestojnë kundër qeverisë dhe...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)


Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.